



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 5 shkronja b, 12.2 shkronja c dhe 17 shkronja k të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neneve 3.1.1 dhe 25 të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr. 03/L-164, Udhëzimin Administrativ nr. 22/2010 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, dhe nenin 15.2 shkronja c të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2014, miratoi

RREGULLORE

PËR CAKTIMIN E KRITETREVE PËR DHËNIEN E SHTËPIVE NË SHFRYTËZIM NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË FSHATIN BALLOC

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të shtëpive në pronësi të Komunës së Podujevës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc.

Neni 2

Me këtë Rregullore gjithashtu përcaktohet radha e përparësisë së dhënies në shfrytëzim, mënyra e shfrytëzimit, administrimi dhe mirëmbajtja e shtëpive, varësisht nga dinamika e sigurimit të donacioneve dhe realizimit të projektit në faza të caktuara për largimin e objekteve të banimit montazh dhe ndërtimit të shtëpive të reja.

Neni 3

Shtëpitë e dhëna në shfrytëzim janë aset i Komunës dhe shfrytëzuesi nuk e ka të drejtën e tjetërsimit, dhënies me qira si dhe shfrytëzimit për destinim tjetër përveç banimit.

II. Kushtet e përfitimit për shfrytëzim të shtëpive

Neni 4

Përfitues të dhënies në shfrytëzim të shtëpive, sipas kësaj Rregulloreje, do të jenë familjet me status të banuesit në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc, mbi bazën e dëshmisë përkatëse të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 5

Kriteret për përcaktimin e përparësive:

1. Lartësia e të ardhurave të familjes
 - 1.1 Familjet me të ardhura mujore deri 150 €.....10 pikë
 - 1.2 Familjet me të ardhura mujore prej 150. € deri 250 €..... 8 pikë
 - 1.3 Familjet me të ardhura mujore prej 250 deri 300 €.... 6 pikë
2. Gjendja shëndetësore e anëtarëve të familjes:
Sëmurjet e rënda kronike,
Konsiderohen: sëmurjet malinje, sëmurjet e rënda të gjakut, diabeti i rasteve të rënda të gjakut, diabeti i rasteve të rënda me insulinë, sëmurjet e rënda kronike të veshkave në dializë dhe pas transplantove të veshkës, forma të rënda të astmës, sëmurjet kronike të papërcaktuara të mushkërive, tuberkulozi, skleroza, sëmurjet e sistemit imunitar, format e rënda të çrregullimeve të metabolizmit, epilepsia, sëmurjet tjera të rënda të zemrës dhe neuroza6 pikë
3. Invaliditeti i anëtarëve të familjes
 1. Invalid me mbi 80% të dëmtimit trupor të cilëve ju nevojitet përkujdesja dhe ndihma e personit tjetër10 pikë
 2. Invalid me 71% deri 80% të dëmtimit trupor9 pikë
 3. Invalid me 61% deri 70% të dëmtimit trupor8 pikë
 4. Invalid me 51% deri 60% të dëmtimit trupor7 pikë
 5. Invalid me 41% deri 50% të dëmtimit trupor6 pikë
 6. Invalid me 31% deri 40% të dëmtimit trupor5 pikë
 7. Invalid me 21% deri 30% të dëmtimit trupor4 pikë
 8. Invalid me 10% deri 20% të dëmtimit trupor3 pikë
4. Kriteret shtesë
 1. Familje dëshmori10 pikë
 2. Invalid i luftës së UÇK – së9 pikë
 3. Veteranët e luftës së UÇK – së8 pikë
 4. Familje në përkujdesje të fëmijëve.....8 pikë
 5. Viktimat civile të luftës7 pikë

Neni 6

- Sipërfaqja minimale e banimit për një person të vetëm13 m².
Për çdo anëtar të familjes mbi moshën 10 vjeçare8 m².
Për çdo anëtar të familjes me moshë nga 5 deri 10 vjeçare4 m².

Neni 7

Familjet e dëshmorëve përjashtohen nga kriteret e caktuara me këtë Rregullore dhe janë përfituese të para për dhënien përkatësisht marrjen në shfrytëzim të shtëpive të ndërtuara.

Neni 8

Në kërkesë të Komunës dhe miratimin nga ana e MPMS – së, ndonjë familjeje banuese në lagje që posedojnë troje, iu sigurohet materiali ndërtimor.

Neni 9

1. Kuvendi i Komunës, për ndarjen e shtëpive përkatësisht për dhënie në shfrytëzim, ngitë Komision të veçantë prej 5 anëtarëve, një nga të cilët duhet të jetë anëtar i Organizatave të Dala nga Lufta e UÇK – së.
2. Në cilësinë e vëzhguesit, në punën e Komisionit, merr pjesë përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
3. Komisioni e ka mandatin deri në përfundimin e projektit për ndërtimin e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve, përkatësisht deri në përfundimin e mandatit të Kuvednit.
4. Për punën e vet Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 10

1. Komisioni e bënë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit në Lagjen e Dëshmorëve, bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Strukturat e Komunës dhe me përfundimin e ndërtimit të shtëpive e bënë ndarjen e tyre përkatësisht dhënien në shfrytëzim.
2. Kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive përcaktohen me kontratë të veçantë, mbi bazën e rekomandimit të Komisionit.

Neni 11

Komisioni, në funksion të lirit të hapësirës për ndërtim të shtëpive, varësisht prej sigurimit të mjeteve financiare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, rekomandon për largimin e objekteve aktuale të banimit – kontejnerëve.

Neni 12

1. Komisioni publikon Listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara gjatë vlerësimit.
 2. Kundër listës së publikuar të Komisionit, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në afat prej 15 ditësh pas publikimit të listës.
- Ankesa ushtrohet përmes Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve.

Neni 13

Rregullorja hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-463-45840

**Podujevë,
27 maj 2014**

